

UDHEZIM

Nr.1, date 30.12.2003

PER

PERDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE

Ne mbështetje të pikës 7.2 të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 675, date 20.12.2002 "Per perdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet", Agjencia e Prokurimit Publik

UDHEZON:

I. REGJISTRI I PARASHIKIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE

1. Institucionet e përmendura në Vendimin nr 675, datë 20.12.2002 të Keshillit të Ministrave duhet të paraqesin pranë Agjencisë së Prokurimit Publik brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, sipas formularit nr 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Një kopje e këtij regjistri duhet t'i dërgohet edhe Drejtorise së Thesarit dhe Buxhetit pranë Ministrisë së Financave, e cila ua shpërndan degeve të thesarit në rrethe.

2. Formulari të përmbajë keto të dhëna:

- a) Objektin e prokurimit që do të realizohet,
- b) Fondin limit që parashikohet për objektin që do të prokurohet, të ndarë në investime dhe shpenzime operative,
- c) Kohën e parashikuar për zhvillimin e procedurës së prokurimit,
- d) Procedurën e prokurimit që do të përdoret për objektin e prokurimit.
- e) Burimin e financimit

3. Për fondet e krijuara ose të shtuara pas miratimit të buxhetit të shtetit, ndryshimi i regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike do të dërgohet menjëherë pas vënies në dispozicion të fondit.

II. PROKURIMI I MALLRAVE, SHËRBIMEVE DHE NDËRTIMEVE

1. Në kuptim të pikës 3.2 të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr 675, datë 20.12.2002 "Për përdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet" me "fonde të krijuara" do të kuptojmë fondet e parashikuara në fillim të vitit buxhetor. Gjithashtu, procedurat e prokurimit për fondet e krijuara ose të shtuara, nisin menjëherë pas vënies në dispozicion të këtyre fondeve, pra me marrjen e miratimit nga Ministria e Financave për celjen e këtyre fondeve.

Në këtë rast, institucionet qendrore duhet të njoftojë Drejtorinë e Thesarit dhe të Buxhetit në Ministrinë e Financave, Agjencinë e Prokurimit Publik, të cilat bëjnë ndryshimet në regjistrat përkatës.

III. REGJISTRI I REALIZIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE

1. Institucionet e përmendura në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.675, datë 20.12.2002, të paraqesin pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, regjistrin e realizimeve të prokurimeve publike, sipas formularit nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Formulari nr.2 të përmbajë këto të dhëna:

- a. Objektin e prokurimit që është realizuar,
- b. Fondin limit me te cilin është zhvilluar procedura e prokurimit, të ndarë në investime dhe shpenzime operative,
- c. Vlera totale e ofertës fituese të procedurës së prokurimit të ndarë në investime dhe shpenzime operative,
- d. Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit,
- e. Lloji i procedurës së prokurimit që është përdorur për objektin e prokurimit,
- f. Emri i firmës së shpallur fituese,

IV. TE VEÇANTA

1. Institucionet qendrore brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim përcaktojnë listat e mallrave, të ndërtimeve apo të shërbimeve të njëjta të parashikuara nga entet e varesisë, për të cilat ato gjykojnë se do të kryhen procedurat e përqëndruara të prokurimit. Këto procedura prokurimi do të kryhen nga institucioni qendror ose nga institucioni i autorizuar prej tij.

Me mallra, ndertime dhe shërbime të tjera në kuptim të pikës 6.1/1 të këtij vendimi do të kuptohet jo vetëm mallrat, ndertimet dhe shërbimet që nuk janë të njëjta por edhe ato që janë të njëjta, për të cilat procedurat e prokurimit për arsye objektive nuk mund të realizohen në praktike nga institucioni qendror ose nga institucioni i autorizuar prej tij.

Me "Mallra të njëjta" në kuptim të këtij vendimi do të kuptohet ato mallra që kanë të njëjtin emër dhe të njëjtin funksion.

Me "Ndertime të njëjta" në kuptim të këtij vendimi do të kuptohet ndertimet e reja që kanë projekt, preventiv dhe strukture kosto të njëjta.

Me "Shërbime të njëjta" në kuptim të këtij vendimi do të kuptohet shërbimet që kanë të njëjtin objekt prokurimi.

2. Entet, të cilat prokurorin "Mallra që prishen", sipas listës së përcaktuar në këtë Udhëzim, lejohen t'i kryejnë vetë procedurat e prokurimit konform ligjit nr.7971 datë 26.07.1995 "Për Prokurimin publik"

"Mallra që prishen", në kuptim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 146 datë 07.03.2003, "Për një ndryshim në VKM nr. 675, datë 20.12.2002 "Për përdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet", do të jenë mallrat sipas listës së mëposhtme:

1. Mish i freskët dhe Nenproduktet e tij
2. Prodhime deti
3. Vezë
4. Bukë
5. Qumësht dhe Nenproduktet e tij,
6. Fruta
7. Zarzavate
8. Perime

Kesaj liste mund t'i shtohen sipas rastit edhe mallra të tjerë, me miratim të Agjencisë së Prokurimit Publik.

3. Entet prokuruese per llogari te cilave kryhen procedurat e prokurimit sipas pikes 6.2 te ketij vendimi jane te detyruara te paraqesin prane institucionit te ngarkuar nga kjo pike e vendimit per kryerjen e procedurave te prokurimit te gjitha te dhenat teknike dhe sasiore qe enti i konsideron te nevojshme per realizimin e nje procedure prokurimi.

Institucionet e ngarkuara sipas pikes se mesiperme te vendimit, pasi grumbullojne te dhenat e derguara nga entet prokuruese, duke u mbeshtetur dhe ne regjistrin e parashikimeve te prokurimeve publike, i cili i eshte derguar nga ana e Agjencise se Prokurimit Publik, kryejne procedurat e prokurimit. Keto institucione pasi perllogarisin fondin, i cili do te jete shuma e fondeve te miratuara per seicilin institucion, per realizimin e procedurave te prokurimit i referohen Kapitullit I, pika 4 te UKM nr 1, date 01.01.1996 "Per prokurimin publik" .

4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 20.12.2002 "Për përdorimin e fondeve buxhetore të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet", për zbatimin e pikës 6.2, nuk përfshihen Institucionet Qendrore të pavarura, të cilat nuk kane ente varësie me perjashtim të blerjes së autoveturave të Titullarëve, për të cilat institucionet qendrore të pavarura janë të detyruara të zbatojne pikën 6.2 të këtij Vendimi, në të cilën parashikohet se: "Për blerjet e autoveturave për zyrtarët e lartë të shtetit ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare, sipas përcaktimeve teknike dhe standarteve të sigurisë, të përcaktuara nga Ministria e Rendit Publik".

Persa i perket numrit te references se vendosur ne Ftesen per Oferte pjese e dokumentave te tenderit ju sqarojme se ky numer do te perbehet nga shifrat e meposhtme:

- Dy shifrat e para do te percaktojne institucionin qendror sipas listes bashkelidhur ketij udhezimi;

- Dy shifrat ne vazhdim do te percaktojne institucionet qe jane ne varesi te institucionit qendror. Keto shifra do te percaktohen nga ana e institucionit qendror dhe t'i paraqiten per miratim Agjencise se Prokurimit Publik brenda dates 10 janar 2004. Ne rast se keto institucione nuk do te kene ente varesie atehere keto dy shifra do te jene 00;

- Shifra e peste do te tregojne llojin e procedures se prokurimit konkretisht:

Procedura e prokurimit "Tender i Hapur" do te kete shifren	1
Procedura e prokurimit "Tender i Kufizuar" do te kete shifren	2
Procedura e prokurimit "Tender me Dy Faza" do te kete shifren	3
Procedura e prokurimit "Kerkese per Propozim" do te kete shifren	4
Procedura e prokurimit "Kerkese per Kuotim" do te kete shifren	5
Procedura e prokurimit "Prokurim i Drejteperdrejte" do te kete shifren	6
Procedura e prokurimit "T.Hapur Nderkombetar"do te kete shifren	7
Procedura e prokurimit "T.Kufizuar Nderkombetar"do te kete shifren	8
Procedura e prokurimit "K.Kuotim Nderkombetar"do te kete shifren	9

- Shifrat e tjera ne vazhdim do te percaktojne objektin e prokurimit sipas Kodit Buxhetor.

Udhëzimet e APP-së nr.1, datë 06.01.2003, nr.2, datë 07.04.2003 dhe nr. 8 datë 18.02.2003 shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

D R E J T O R I
Behar ZENELI

FORMULARET E UDHEZIMIT

REGJISTRI I PARASHIKIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE

